

SKANERI OPTIMAL I PRODUKSIONIT ME SHPEJTËSI TË LARTË



Skaner prodhuesi imageFORMULA DR-X10C

Nëse biznesi juaj është serioz për skanimin, kemi një skaner të jashtëzakonshëm prodhuesi që ofron rendiment të niveleve më të larta. DR-X10C është projektuar në mënyrë të atillë që barra e mbushjes së saktë, manovrimit dhe procesimit të dokumenteve tuaja të zgjidhet pa mund nga vetë pajisja dhe jo nga ju.

Optimumi në produktivitet

DR-X10C është një skaner ultraproduktiv A3 me shpejtësi skanimi deri në 260 ipm (A4, orientim peizazhi). Ky efikasitet i jashtëzakonshëm arrihet duke përdorur një procesor të dedikuar në firmuerin e pajisjes, pavarësisht kompjuterit tuaj, për të kryer pjesën më të madhe të procesimit të imazhit. Modaliteti i shpejtësisë së lartë u lejon imazheve 300 dpi të skanohen dhe përmirësohen në imazhe 400 dpi dhe 600 dpi.

DR-X10C

SHPEJTËSI NË
BARDHEZI DHE ME
NGJYRA
130 PPM / 260 IPM

VOLUMI I
KËSHILLUAR DITOR
60 000 SKANIME/
DITË

VETËMBUSHËSJA E
DOKUMENTEVE ME
500 FLETË

3 SENSORË
PIKASJEJE
MBYSHJEJE DYSHE

PROJEKTUAR PËR TË ARRITUR REZULTATE TË PAKAPSHME

Mbushje pa mund:

DR-X10C është i pajisur me një ADF të madhe 500-fletëshe. ADF mund të rregullohet në mes me udhëzues të fiksueshëm dhe ka rregullim lartësie (500, 300 dhe 100 fletë) sipas volumit të tufave që skanohen – duke kursyer kohë dhe duke rritur prodhimin në tërësi.

Pikasje ultrasonike për mbushjen dyshe

Pajisur me 3 sensorë ultrasonik me kontroll të pavarur, DR-X10C ofron pikasje të saktë të mbushjes dyshe dhe qëndrueshmëri. Për më tej sensorët mund të konfigurohen për të aktivizuar ose ON, ose OFF, sipas distancës së caktuar nga skaji kryesor i imazhit të skanuar – duke e bërë skanimin e dokumenteve me shënime ngjytëse dhe etiketa komod dhe të lehtë.

Zbulim i kapëseve:

Zbulimi novator i kapëseve nga Canon ndalon mbushjen në çast kurdo që pikaset ndonjë kapëse në mënyrë që të mos dëmtohet pajisja ose dokumenti.

Kontroll aktiv i forcës së veçimit:

Ky funksion novator ofron mundësinë e administrimit të një larmie të gjerë materialeesh, nga dokumentet e trasha deri tek ato të brishta me 5 cilësime force që kontrollohen në formë elektronike. Përfitimet e veçanta gjenden kur skanoni dokumente të brishta ku mund të arrini veçimin e nevojshëm pa rrezikun e dëmtimit të dokumenteve – duke garantuar nivelet më të mira të mundshme të veçimit të dokumenteve dhe të qëndrueshmërisë së mbushjes.

Ritënim i mbushjes dyshe:

Ky funksion unik rezervon automatikisht dokumentet në mbushëse kur pikaset mbushje dyshe dhe tenton t'i rimbushë. Skanimi i zarfeve herë pas herë është gjithashtu i thjeshtë – pas pikasjes thjesht pranojeni imazhin duke shtypur butonin në panelin e kontrollit dhe skanimi vazhdon automatikisht – duke përmirësuar produktivitetin e përgjithshëm.

Pikasje madhësie dhe e drejtimit të tekstit në çast:

Një sensor i dedikuar i ndodhur brenda skanerit, pikas automatikisht dhe në çast madhësinë dhe këndin e drejtimit të dokumentit fizik që kalon përmes skanerit, duke garantuar rezultate të qëndrueshme dhe të sakta.





NJË SKANER PRODUKSIONI ME SHPEJTËSI TË LARTË, A3



KONTROLL I MËTEJSHËM KURDO QË JU NEVOJITET

CaptureOnTouch

Skanim intuitiv - Me ndërfaqen praktike të Canon CaptureOnTouch mund të skanoni me lehtësi dokumente letre në arkiva digjitale dhe t'i ruani apo dërgoni drejt destinacioneve të ndryshme, duke përfshirë shërbimet e resë kompjuterike. Përmban një funksion Full Auto Mode që arrin funksionim të thjeshtuar skanimi me rezultate të cilësisë së lartë. Mund të krijoni skedarë të kërkueshëm PDF duke përdorur teknologjinë e integruar OCR dhe të ruani veprimet e shpeshta në menyne e shkurtoreve

Kofax VRS

Kur kërkoni rezultatet më të mira të mundshme, arrijini me DR-X10C dhe Kofax Virtual Rescan (VRS) Professional. Teknologjia e mirënjohur e fushës së përmirësimit të imazhit realizon rezultate mahnitëse edhe nga dokumentet burimore me cilësinë më të dobët, duke reduktuar si kohën e përgatitjes së dokumenteve, ashtu edhe ndërhyrjen manuale. Karta opsionale Kofax VRS Professional CGA përfshin një sërë funksionesh automatike që përmirësojnë proceset e skanimit, si OCR / ICR dhe minimizojnë riskanimet për efikasitet optimal.

Njohuri për figurën

Kur cilësia e imazheve është e rëndësishme primare, DR-X10C vjen në natyrën e vet me një rezolucion optik prej 600 dpi dhe mundësi të shumta të integruara për përmirësimin e figurës. Për të evituar grumbullimin e pluhurit dhe përkeqësimin e imazhit, DR-X10C përdor një fryrëse automatike, fshirëse dhe mekanizëm mbulues për ta mbajtur sensorin të pastër dhe cilësinë e figurës së lartë.

Funksione të mëtejshme të përpunimit të imazhit

Për fuqi dhe lehtësi të mëtejshme gjatë punës, DR-X10C vjen me një larmi funksionesh për procesimin e imazhit. Këto përfshijnë përmirësimin e tekstit, vetëpikasjen e ngjyrave, parandalimin e derdhjes së bojës, reduktimin e hijeve, konturin e zi dhe heqjen e vrimave të perforimit. Përfshihet gjithashtu një rul i zgjedhshëm sfondi (bardhezi dhe me ngjyra). Thjesht zgjidhni se cilin sfond dëshironi në cilësimet e programit drejtues dhe DR-X10C do ta rrotullojë në cilësimin tuaj të preferuar.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

 **imageFORMULA**
DR-X10C

Tipi	Skaner tryeze me fletëmbajtëse	
Sensori i leximit të dokumenteve	CMOS CIS 3-Line Sensor	
Rezolucioni optik	600 dpi	
Burimi i dritës	LED RGB	
Ana e leximit	Njëanësh / dyanësh / anashkalim faqesh bosh / Folio	
Ndërfaqja	USB me shpejtësi të lartë 2.0 & SCSI-3 Kartë opsionale Kofax VRS Professional CGA	
Përmasat	Sirtari i mbyllur: 528 (Gj) x 563 (Th) x 375 (L) mm Sirtari hapur: 528 (W) x 861 (D) x 432 (H) mm	
Pesha	Afro 39 kg	
Nevojat për energji	AC220 – 240 V (50 / 60Hz)	
Konsumi i energjisë	Skanimi: 125W e poshtë, Modaliteti pasiv: 4,5 W e poshtë Fikur: 0W	
Mjedisi i përdorimit	10 – 32,5°C (50 – 90,5°F), Lagështira: 20 – 80% RH	
Standardet mjedisore	RoHS	
SHPEJTESIA E LEXIMIT*	DR-X10C	
(A4, portret)		
Bardhezi/shkallëzim grije	200 dpi / 300 dpi	100 ppm / 200 ipm
Ngjyra	200 dpi	100 ppm / 200 ipm
Ngjyra	300 dpi	100 ppm / 170 ipm
(A4, peizazh)		
Bardhezi/shkallëzim grije	200 dpi / 300 dpi	130 ppm / 260 ipm
Ngjyra	200 dpi	130 ppm / 260 ipm
Ngjyra	300 dpi	130 ppm / 260 ipm
SPECIFIKIMET PËR DOKUMENTET		
Gjerësia	50,8–305 mm	
Gjatësia	70–432 mm	
Trashësia	Mbushje automatike: 52 – 128 g/m ² (0,06 – 0,15 mm) Modaliteti i anashkalimit: 42 – 255 g/m ² (0,05 – 0,3 mm) 3000 mm maks (E përzgjedhshme në panelin e kontrollit të MS Windows)	
Modaliteti i dokumenteve të gjata	Metoda me rul ngadalësues	
Ndarja e letrës	500 fletë	
Kapaciteti i vetëmbushës	Zgjedhje për 500, 300, 100 fletë dhe MANUAL / BYPASS Feeding Mode Offset Feeding me udhëzues të fiksueshëm anësorë	
DALJA		
Rezolucioni	100 x 100 dpi, 150 x 150 dpi, 200 x 200 dpi, 240 x 240 dpi, 300 x 300 dpi, 400 x 400 dpi, 600 x 600 dpi	
Modaliteti	Black and White, Error Diffusion, Advanced Text Enhancement, Advanced Text Enhancement II, 8-bit Greyscale (256-level), 24-bit Colour, Auto color detection, Active threshold	
VEÇORITË E VEÇANTA	Detektim automatik i madhësisë së faqeve, Pjerrtësi, Kapërcim faqesh bosh, Njohje orientimi teksti, Colour Dropout, (RGB / custom) / Enhancement (RGB / custom), Reduktum Moire, Prevent Bleed Through / Remove Background, Punch Hole Removal, MultiStream, Auto Power On / Off (Via USB), Rapid Recovery System, Ultrasonic Double Feed Detection (sensorë të rregullueshëm në mënyrë të pavarur), Manual / Bypass Feeding, Active Separation Torque Control, Double Feed Re-try Mechanism, Job / User Registration Buttons, Verify Scan / Count Only Mode, Buzzer Alarm, Selectable Background (White / Black), Barkod / Njohje kodesh 2D, Active threshold.	
PROGRAMET E PËRFSHIRA KOMPUTERIKE	Softueri drejtues ISIS / TWAIN	
Për sistemin e përdorimit Windows	CaptureOnTouch	
Opsionet	Para-Imprinter Pas-Imprinter Dekoder Patchcode Kartë Kofax VRS Professional CGA Njësi skaner të shtrirë A4 102/202	
Pjesët e konsumit	Set ruli ndërrimi Fleta e pastrimit Fishek Boje	
Aksesorët	A4 Flatbed Scanner Unit 102 A3 Flatbed Scanner Unit 202	
Cikli i këshilluar ditor i punës	60 000 skanime/ditë	

* Shpejtësitë e skanimit varen nga specifikimet e kompjuterit dhe cilësimet e funksionit.

Disa foto simulohen për qartësi riprodhimi. Të gjitha të dhënat bazohen në metodat standarde të testimit të "Canon". ™ dhe ®: Të gjitha emrat e kompanive dhe/ose të produkteve janë marka tregtare të prodhuesve përkatës në tregjet dhe/ose shtetet e tyre.

Vizitoni faqen e internetit të Canon për më shumë informacion.



A4 Flatbed Scanner Unit 102



A3 Flatbed Scanner Unit 202

Ideal për përmirësimin e procesit në zyrat me ngarkesë

Produktiviteti i pamposhtur kombinohet me funksionin pa vështirësi për ta bërë DR-X10C skanerin ideal për procese skanimit kritike për biznesin, si p.sh. faturimi dhe mbajtja e dosjeve.

Ideal për zyrat e specializuara dhe ofruesit e shërbimit të skanimit

Qëndrueshmëria e jashtëzakonshme, ndërsa punon me 260 imazhe në minutë dhe me një cikël pune ditore prej 60 000 skanimesh, garanton që DR-X10C të jetë skaneri mbi të cilin mund të mbështeteni gjithnjë.

Jepuni drejtim përjashtimeve me opsionin e shtrirë

Skanoni libra të lidhur, ditare dhe materiale të brishta duke shtuar Flatbed Scanner Unit 102 për dokumente deri në formatin A4, ose Flatbed Scanner Unit 202 për skanime në formatin A3. Me lidhjen përmes USB-së, këta skanerë me shtrat të sheshtë punojnë më së miri me skanerët imageFORMULA në formë paralele që ju mundëson zbatimin e optimizimeve të njëjta të figurës në çfarëdo skanimit.

Seti i zhvillimit programatik (SDK)

Setet dhe mjetet e zhvillimit programatik ofrohet përmes Canon Developer Programme. Për t'u regjistruar për programin:

- Vizitoni faqen e regjistrimit - <https://developers.canon-europe.com/developers/s/login/SelfRegister>
- Nëse keni ndonjë problem gjatë regjistrimit, ju lutemi të kontaktoni me administratorin e CDP te cdp-admin@canon-europe.com

Canon

Canon Electronics Inc.
canon-elec.co.jp
Canon Europe
canon-europe.com
Albanian edition
© Canon Europa N.V., 2024